



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

EC MA NDARYSHE

## THIRRJE PËR OFERTË

### **Raport/dokument për turizmin rural potencial i zhvillimit ekonomik në rajonin e Prizrenit**

Programi “Zbatimi i programeve të strategjisë të EC” i përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’, bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), ka për qëllim vazhdimin e përpjekjeve të organizatës për gjithëpërfshirje dhe qëndrueshmëri me fokus te qytetari si garantuesi kryesor i demokracisë dhe zhvillimit.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij programi, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për raport/dokumentin “**Raport/dokument për turizmin rural potencial i zhvillimit ekonomik në rajonin e Prizrenit**”.

Raporti duhet të ofrojë informata mbi gjendjen e turizmit në përgjithësi për komunën e Prizrenit, Dragashit, Malishevës, Suharekës, Mamushës dhe Rahovecit. Specifikisht duhet të zërthehet, agroturizmi, ekoturizmi, turizmi kulturore etj. Gjithashtu gjatë fazës së përpilimit të raportit do të realizohen anketa në teren me respondent, rezultatet e të cilave do të zërthehen në raport.

Gjithashtu, raporti duhet të përmbajë konkluzat e rekomandimeve konkrete lidhur me turizmin rural sa i përket Prizrenit dhe rajonit.

#### **Kriteret për ofertim:**

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim: Për ekspertët/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/ OJQ, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH- së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së), CV-të e personave që do të angazhohen për realizimin e aktivitetit;
- Oferta duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të metodologjisë së hulumtimit/analizës duke ofruar së paku informata mbi dokumentacionin që do të analizohet, palët që do të përfshihen/kontaktohen dhe strukturën e propozuar të dokumentit. Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe ato të transportit;
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyret e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) deri më 15.11.2023, ora 15:00 me shënim: **“Raport/dokument për turizmin rural potencial i zhvillimit ekonomik në rajonin e Prizreni”**. Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org) deri më 13.11.2023.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm ekspertët /grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të fitues do të informohen/kontaktohen.